



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KUÇOVË
NJËSIA E PROKURIMIT**

Datë 11 . 08 .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Pajisje mobilerie për shkollën Aleksandër Markaçini”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Karrige Kodi 39112000-0.

Tavolina Kodi 39121200-8.

Dollapë Kodi 39122100-4.

Dërrasa të zeza Kodi 39292100-6.

VLERA E FONDIT LIMIT : 3 366 600 *(tre milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind)* lekë pa tvsh, të vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Kuçovë, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak Nr 51 të datës 22.07.2026, si dhe të konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën Nr 655/1 Prot datë 29.07.2026, të protokolluar pranë nesh me Nr 3053/1 Prot datë 30.07.2026.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kuçovë ka hartuar procesverbalin për

argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

Sipas kushteve të përgjithshme të pranimi/kualifikimit

2.1.1. Ofertuesi duhet të paraqesi Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2026, duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.

4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale për vitin 2026 është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga data shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë totale jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë në emër të vet për objektin e prokurimit, që vërteton cilësinë e menaxhimit të cilësisë, ISO 9001 : 2015 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që ofertuesit duhet të jenë të certifikuar për cilësinë si dhe të kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë.

➤ **ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent**

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është **standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar**. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë).

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin krijimin e infrastrukturës së nevojshme për kompletimin dhe zhvillimin e programeve mesimore në Shkollën e mesme të përgjithshme “Aleksandër Markaçini” Njësia Administrative Kozare, Bashkia Kuçovë, me qëllim furnizimin me pajisje cilësore nisur nga fakti që bëhet fjalë për ambiente ofrim mësimi ndaj fëmijëve dhe nisur nga kohëzgjatja e konsiderueshme që përdoren këto pajisje, vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm dhe në përputhje me natyrën dhe volumnin e kontratës që prokurohet.

Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe certifikata ekuivalente të ISO 9001:2015, e cila i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me sukses dhe në kohë.

2.2.3 Operatori ekonomik për artikujt e kërkuar duhet të paraqesë certifikatat e produktit si më poshtë.

- Tavolinë nxënësi dyvendëshe Arsimi i Mesëm; SSH/EN 1729-2:2023 e vlefshme ose ekuivalente.
- Karrige nxënësi Arsimi i Mesëm, SSH/EN 1729-2:2023 e e vlefshme ose ekuivalente.

Gjithashtu për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente ose të përditësuara me ato më sipër, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit të 79, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Këto kërkesa janë të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimi dhe ka të bëjë me testet funksionale, të përshtatshmerisë të funksionalitetit dhe të qëndrueshmerisë gjatë përdorimit.

- Tavolinë nxënësi dyvendëshe Arsimi i Mesëm; SSH/EN 1729-2:2023 e vlefshme ose ekuivalente.
- Karrige nxënësi Arsimi i Mesëm, SSH/EN 1729-2:2023 e e vlefshme ose ekuivalente.

Referuar Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS), SSH EN 1729-2:2023 është standardi aktual shqiptar për “*Mobilje – Karrige dhe tabela për institucionet arsimore*”

Kërkesat e sigurisë dhe metodat e provës”, i cili ka hyrë në fuqi në date 15 gusht 2024, duke zëvendësuar SSH EN 1729-2:2012+A1:2015, i cili është tërhequr më 9 shkurt 2024.

Standardi SSH EN 1729-2:2023 përcakton kërkesa sigurie dhe metoda testimi për karrige dhe tavolina të destinuara për përdorim të përgjithshëm në institucionet arsimore. Fusha e zbatimit të tij lidhet drejtpërdrejt me mobilitet shkollorë që janë objekt i këtij prokurimi.

Është një standart që përdoret për të përcaktuar kërkesat në lidhje me dimensionet që duhet të ketë një tavolinë nxënësi për përdorim të zakonshëm në mënyrë që të sigurohet një qëndrim i përshtatshëm për nxënës dhe gjithashtu përshkruan edhe metodat e testimeve të kryera për

përcaktimin e tyre. Një certifikatë e tillë nënkupton që produkti i prodhuar respekton këto dimensione dhe është i sigurtë për një përdorim të tillë. Gjithashtu ky standart specifikon kërkesat që duhet të plotësojnë këto tavolina për sa i përket sigurisë, forcës dhe qëndrueshmërisë për një përdorim rreth 8 orë në ditë dhe një certifikatë e tillë nënkupton që mobilja e prodhuar i plotëson këto standarte.

Mobiliet shkollore përdoren çdo ditë dhe në mënyrë intensive nga fëmijë dhe nxënës të grupmoshave të ndryshme. Për këtë arsye, siguria e tyre nuk mund të vlerësohet vetëm në bazë të pamjes vizuale, materialit të deklaruar nga ofertuesit ose përmasave të përgjithshme të produktit.

Duke marrë në konsideratë se EN 1729-2:2023 nuk është një standard i përgjithshëm për çdo lloj mobilie, por fusha e tij është përcaktuar posaçërisht për karrige dhe tavolina për institucione arsimore, duke përfshirë edhe mjedise të edukimit parashkollor dhe të kujdesit për fëmijët, si dhe kërkesa nuk synon të vendosë karakteristika të panevojshme ose të lidhura me një prodhues të caktuar, por përcakton një nivel teknik dhe sigurie që duhet të përmbushë produkti në mënyrë që ai të jetë i përshtatshëm për përdorimin e synuar, disponimi nga ana e ofertuesve të këtij standarti garanton autoritetin kontraktor për furnizimin e mallrave me sukses në kohë si dhe në përputhje me standartet EN të përcaktuar dhe nga Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS).

Për këtë arsye, përcaktimi i këtij kriteri në procedurën e prokurimit që ka objekt furnizimin me mobilieri shkollore është teknikisht i arsyeshëm dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme.

2.2.4 Ofertuesit duhet të paraqesin edhe deklaratat si më poshtë :

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit të artikujve), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në adresat e përcaktuara në DST.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponibilitet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK me mjetet e tyre që kanë në dispozicion, si dhe garanci për produktet që do të sjellin.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik ose me kontratë shërbimi për këtë objekt për realizimin e procedurës së prokurimit, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme ose me kontratë shërbimi dhe dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara në datën e hapjes së ofertave, nga autoritetet përgjegjëse shtetërore gjithashtu dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara kombëtare ose ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë për çertifikimin e punonjësve si më poshtë:

- Mobilier/Montator 1 (një)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën....”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokurimit, autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

Kërkesa për Specialistë të certifikuar garantojnë Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i çertifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin me cilësi dhe në kohë të kontratës në tërësi.

Objekti i procedurës së prokurimit përfshin në vetvete edhe procesin e prodhimit të mobiljeve, pra përmban elemente shërbimi për të cilën është e nevojshme që nga ofertuesit e mundshëm

ekonomike të disponohet edhe një staf i cili të bëjë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi. Punonjësi i kërkuar është i nevojshëm, duke qënë se kjo procedurë prokurimi ka në përbërjen e saj përveç mallrave edhe transportimin dhe instalimin/montimin e tyre e bën të domosdoshëm kërkesën për disponimin nga ana e ofertuesve edhe të një stafi të çertifikuar për realizimin në kohën e duhur të lëvrimit dhe instalimit e tyre në shkollën Aleksandër Markaçini.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Në specifikimet teknike që janë publikuar në dokumentet standarte të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizojnë produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, por i është referuar Katalogut për blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim të miratuar nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet teknike si më sipër, duhet të plosohen me rigorozitet në momentin e zbatimit të kontratës.

Pavarësisht lidhjes së kontratës, procedura do të quhet e finalizuar në momentin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga një komision i posaçëm i ngritur nga autoriteti kontraktor.

Ne respektim të nenit 36, 37 të LPP-se në të gjitha rastet të mallrave objekt prokurimi kur përmendet “marke” përfshihet termi “ekuivalent”.

NJËSIA E PROKURIMIT